



## RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për auditimin ligjor të Pasqyrave financiare, të fondeve të përfituara  
dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2017 nga partia

"Fryma e Re Demokratike"

Auditues Ligjor: Afrim Suli

Angazhuar nga: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

Korrik 2018



## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve**  
 Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

### I. Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare 2017

#### Opinionit me rezervë

Në përmbushje të kushteve të angazhimit me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve (pala angazhuese), ne kemi audituar pasqyrat financiare të Partisë "Fryma e Re Demokratike" (pala përgjegjëse), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e aktiviteteve dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Partisë "Fryma e Re Demokratike" më datën 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo-Fitimpruese (SKK-të për OJF-të).

#### Baza për opinionin me rezervë

- Në pasqyrën e pozicionit financiar me datë 31 Dhjetor 2017, është paraqitur si detyrim në zërin "Grante ,donacione,subveçione" shuma prej 745,892 lekë dhe është shpjeguar për natyrën e tij në shënimin nr.6 të pasqyrave financiare. Nga evidenca që siguroam për këtë çështje gjatë auditimit nuk provohet që subjekti politik të ketë detyrime ndaj të tretëve, që rrjedhin nga rilogaritje apo kushte, për grante të marra, financime buxhetore, kontribute të marra në avancë apo premtime të kushtëzuara për të dhënë. Sipas gjyqimit tonë shuma e mësipërme vjen nga çelja e vitit paraardhës dhe duhet të jetë pjesë e aktiveve neto të pakufizuara, dhe kështu duhen paraqitur në raportimet financiare të ardhëshme.
- Gjatë fushatës zgjedhore për kuvendin 2017 subjekti ka lidhur kontrata huapërdorje(pa shpërblim) për ambiente të shfrytëzuara si zyra elektorale. Këto furnizime janë deklaruar si kontribute vullnetare në natyrë dhe shpenzime fushate në raportimet financiare për

fushatën zgjedhore drejtuar KQZ-së, si nga subjekti politik ashtu dhe nga ekspertët financiar të monitorimit, të vleresuara për shumën totale 115.600 lekë, por nuk janë pasqyruar në të ardhurat dhe shpenzimet vjetore të deklaruar në pasqyrat financiare 2017. Ndonëse pa efekte në aktivet neto të pakufizuara dhe me materialitet të vogël, për shkak të natyrës së kontributit dhe kërkesave rregulatore, pasqyrimi i tyre është i rëndësishëm në leximin e pasqyrave financiare nga përdoruesit.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepem Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti i partisë "Fryma e Re Demokratike" në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Financat e Partisë në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi dhe të personat e ngarkuar me financat e Partisë janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo-Fitimprurese (SKK-të për OJF-të), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për të zhvilluar aktivitetin ekonomik dhe financiar të Partisë në përputhje me kërkesat specifike të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar dhe me udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Ata që janë të ngarkuar me financat e partisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Partisë.

#### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk një është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

#### **II. Raport mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregulatore**

Ky seksion i raportit trajton përgjegjësitë e tjera të raportimit në raportin e audituesit mbi pasqyrën financiare, përveç përgjegjësisë së audituesit sipas SNA-ve.

Këto përgjegjësi të tjera raportuese burojnë nga termat e kontratës, në të cilën Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ-ja) si organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive kërkon opinionin tonë edhe për përputhshmërinë e veprimeve ekonomike

dhe financiare që lidhen me kërkesat specifike të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe udhëzimet e KQZ-së, si burimet e financimit, procedurat e marrjes së donacioneve jopublike, dokumentimit dhe të regjistrimit të tyre, identifikimin e dhuruesve, publikimin e tyre, etj.

Bazuar në auditimin tonë, në vijim po ju paraqesim informacionet, gjetjet dhe konstatimet e arrituara për veprimet ekonomike dhe financiare që kanë rregullime dhe kufizime ligjore dhe opinionin për përputhshmerine e tyre me këto kërkesa.

Partia "Fryma e Re Demokratike" si person juridik, është e regjistruar në sistemin tatimor me NIPT-in L31525455 dhe ka bërë deklaratimet e duhura sipas përgjegjesive tatimore dhe aktivitetit që ajo ka kryer. Gjithashtu ajo ka plotësuar detyrimet ndaj KQZ-së për raportim e shpenzimeve dhe të ardhurave të fushatës zgjedhore dhe të pasqyrave financiare vjetore 2017.

Nga verifikimet rezultoi se gjatë periudhës raportuese 2017, subjekti politik ka realizuar të ardhura(hyrje) nga burimet dhe në shumat e treguara në tabelën vijuese:

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2017	Viti Paraardhës 31.12.2016
1	Të ardhura nga tarifat e antarësimit	950,000	-
2	Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit	115,600	-
3	tjera të financimit	5,617,326	2,250,000
	<b>Shuma</b>	<b>6,682,926</b>	<b>2,250,000</b>

Ne zerin "Të ardhura nga tarifat e antarësimit" janë pasqyruar arkëtimet e tarifave e antarësimit, bazuar në statutin e partise. Për vitin 2017 janë arkëtuar tarifa nga 19 antarë partie, me shuma individuale nga 50.000 deri në 100.000 leke secili. Arkëtimet janë kryer me lekë në dore, janë dokumentuar me mandat arkëtimi dhe regjistruar rregullisht në ditaret dhe librat kontabël.

Subjekti politik ka siguruar gjithashtu të ardhura nga buxheti i shtetit në shumat e paraqituara në zërin "Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit". Në këte shumë janë përfshirë të gjitha financimet buxhetore të marra nga 1 Janari deri në 31 Dhjetor 2017 për shumën 5,617,326 lekë. Financimet buxhetore janë pasqyruar për neto, pasi janë zbritur kthimet e fondeve të rillogaritura nga KQZ-ja në bazë të rezultateve zgjedhore në shumën 1,152,214 lekë.

Gjatë fushatës zgjedhore për kuvendin 2017 subjekti ka përdorur ambiente për zyra elektorale, pa shperblim, të dokumentuara kryesisht me kontrata të thjeshta por dhe me kontrata huapërdorje, në të cilat është identifikuar dhuruesi. Ato janë raportuar si kontribute vullnetare në natyrë, vlerësuar nga Eksperti Financiar dhe pranuar nga partia për shumën totale 115.600 lekë dhe vlerat individuale të tyre janë më pak se 100 mijë lekë.

Megjithese ato janë deklaruar në raportimet financiare për zgjedhjet, ato nuk janë regjistruar në të ardhurat dhe shpenzimet vjetore dhe të deklaruara në pasqyrat financiare 2017. Për këtë mungesë është dhënë opinion me rezervë për pasqyrat financiare në pjesëe parë të këtij raporti. Për këto kontribute nuk janë hartuar deklarata dhurimi për secilin dhurues.

Në kuadrin e lehtësive që shteti u bën partive politike, subjekti është pajisur me ndërtesë për selinë qendrore me një kontratë huapërdorjeje (pa shperblim) me Bashkinë Tiranë, e cila është një ndihme financiare e në përputhje me ligjin, por e papasqyruar në raportimet vjetore. Përveç kësaj, nuk është evidentuar asnjë shumë tjetër e financiar prej organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, në mbështetje të subjektit.

Nuk u evidentuan të ardhura të tjera, në para apo natyrë, apo informacione të tjera që lidhen me kërkesa dhe kufizime ligjore, në dokumentat kontabël dhe pasqyrat financiare të paraqitura nga drejtimi financiar i partisë. Shpenzimet e realizuara, të aktivitetit normal dhe ato të fushatës zgjedhore, janë të dokumentuara, të regjistruara dhe raportuara.

Në përfundim të verifikimeve dhe informacioneve të marra, në reference me kërkesat, kufizimet dhe detyrimet e ligjit "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe udhëzimet e KQZ-së, për çështjet që gjejnë zbatim, ju paraqesim opinionin tonë si vijon:

- Burimet e financimit të aktivitetit politik të Partisë "Fryma e Re Demokratike" për periudhën raportuese 2017, kanë ardhur nga tarifat e antarësisë, buxheti i shtetit dhe kontributet vullnetare në natyrë për zyra elektorale. Të ardhurat realizuara dhe të deklaruarra janë në përputhje me burimet e lejuara nga ligji "Për Partitë Politike" i ndryshuar.
- Nuk u evidentuan marrje të fondeve jopublike nga dhurues të pa identifikuar dhe me shuma mbi 100 mijë leke të pa publikuar.
- Detyrimi për regjistrimin i fondeve jopublike në një regjistër të posaçëm dhe nënshkrimin e një deklarate dhurimi për çdo dhurues, siç është rasti i kontributeve vullnetare në natyrë të përdorimit të ambienteve për zyra elektorale, nuk është respektuar si duhet. Nuk ka patur praktika të mëparshme dhe janë mjaftuar vetëm me nënshkrimin e kontratave të thjeshta në të cilat identifikohen dhuruesit.
- Detyrimi që të ardhurat dhe shpenzimet e kryera gjatë aktivitetit politik, të dokumentohen dhe deklarohen duke respektuar legjislacionin në fuqi është zbatuar, përveç kontributeve në natyrë që kane mangësi në regjistrimin dhe pasqyrimin e tyre.


Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në shtojcën bashkëngjitur raportit. Ky përshkrim është pjesë përbërëse e raportit tonë të auditimit.

AS-Audit Services sh.p.k

Afrim Suli

Ortaku Kryesor i Auditimit

Tiranë, më 5 Korrik 2018



## Shtojcë e raportit të audituesit

### Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjyklimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Partisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Partisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë, dhe gjithashtu në përcaktimet ligjore të fushes ku vepron subjekti politik.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.